



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Kumtesë për Media

Rogova merr pjesë në takimin e parë të Panelit të ri Këshillues të NATO-s mbi Rezolutën 1325

Takimi i parë vjetor i Panelit Këshillues të Shoqërisë Civile i NATO-s për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, po mbahet në Bruksel nga data 17-18 Tetor, ku Igballe Rogova, Drejtore Ekzekutive e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) po merr pjesë si anëtare e Grupit Kryesor.

NATO dhe partnerët e saj e njohin rëndësinë e rolit të shoqërisë civile në promovimin e agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, në promovimin e fuqizimit të grave dhe vajzave si dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Përmes Panelit Këshillues të Shoqërisë Civile për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, NATO dëshiron që në mënyrë sistematike, me njohuritë dhe ekspertizën e shoqërisë civile, të përfitojë nga kontributi i tyre në mënyrë që të zhvilloj më tutje agjendën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Përmes këtij takimi, NATO synon të siguroj dhe të forcojë një dialog me akterët e shoqërisë civile i cili do të vazhdoj të kontribuoj në çështjet e ngritura në agjendën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, përfshirë në planifikimin dhe ekzekutimin e operacioneve dhe misioneve të udhëhequra nga NATO. Përfaqësuesja Speciale e NATO-s për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, Ambasadorja Marriët Schuurman, ka inicuar dhe udhëhequr iniciativën për krijimin e Panelit Këshillues të Shoqërisë Civile, si dhe është bashkëbiseduesja kryesore në NATO.

Përzgjedhja e Rogovës është bazuar në rekomandimet e marra nga kombet dhe organizatat ndërkombëtare. Anëtarësimi është i caktuar për një periudhë kohore prej dy viteve dhe mund të ripërtihet. Paneli Këshillues i Shoqërisë Civile përbëhet nga dy grupe, Grupi Kryesor i personave të shoqërisë civile që marrin pjesë personalisht dhe Grupi i OJQ-ve ku secila përzgjedh një person për të përfaqësuar atë OJQ në Panel. Takimi i dytë pritet të mbahet në Maj të vitit 2017, në mënyrë që të kontribuoj në dialogun para ndryshimeve të politikave dhe planit të veprimit të NATO-s për 1325 që do të bëhen në vitin 2018.

Shpeshherë, Rogova është thirrur si nismëtare në punën e saj avokuese mbi RKSOKB 1325. Që nga kalimi i Rezolutës na vitin 2000, Rogova e ka përdorur atë në avokimin për të drejtat e grave për pjesëmarrje në procese vendim-marrëse, fillimisht në fazën e pas luftës. Ajo ka shty përpara draftimin e një raporti me ndikim të madh për NATO dhe akterë të tjerë titulluar [Fakte dhe Fabula 1325](#), lidhur me zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë. Ajo ka qenë plotësisht e përfshirë në përkrahjen e themelimit të Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale e udhëhequr nga ish Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga; në avokimin për drejtësi për gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës; dhe në komisionet rajonale lidhur me të vërtetën dhe pajtimin për këtë qështje. Rogova gjithashtu ka avokuar dhe më pas ka marrë pjesë në draftimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Kosovës për zbatimin e Rezolutës 1325.

Së fundmi, Rogova ka qenë anëtare e Grupit të Ekspertëve Këshillues të Nivelit të Lartë për Studimin e zbatimit të RKSOKB 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Gjatë 15 viteve të fundit, Rogova ka ndarë njohuritë dhe përvojën e saj në mënyrën më të mirë të mundshme drejt zbatimit të Rezolutës së bashku me shumë ushtarakë dhe aktivistë të shoqërisë civile nga vende të pas konfliktit apo në konflikt.

Me 17 Tetor, Zn. Rose Gottemoeller ka filluar punën në pozitën e saj të re si Zëvendëse Sekretare e Përgjithshme e NATO-s.

“Kam kënaqësinë të ju njoftojë për emërimin e Rose Gottemoeller, e cila do t’i sjell NATO-s një përvojë të çmuar në politikën ndërkombëtare të sigurisë, dhe në fushat sikurse kontrolli i armëve dhe marrëdhëniet me Rusinë. Gjithashtu, ajo do të jetë gruaja e parë që do të mbajë këtë pozitë kyçe, e që është një arritje shumë e madhe për NATO,” është shprehur Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.